

20151293786

**L I G J**  
**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR SIGURI DHE SHËNDET**  
**GJATË PUNËS**

Neni 1

Në Ligjin për siguri dhe shëndet gjatë punës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 92/07, 136/11, 23/13, 25/13,164/13, 158/14 dhe 15/15), në nenin 52, në paragrafin (10), "padi për ngritjen e kontestit administrativ" , zëvendësohen me fjalët "ankesë te Komisioni Shtetëror për Vendosje në Shkallë të Dytë në Sferën e Mbikëqyrjes Inspektuese dhe Procedurës Kundërvajtëse".

Neni 2

Titulli para nenit 54 dhe neni 54 ndryshohen si vijon:  
"Zbatimi i procedurave të përshpejtuara

Neni 54

(1) Nëse inspektori i punës konstaton kundërvajtje të neneve 56, 57 dhe 58 nga punëdhënësi, do i ofrojë urdhërpagesë kundërvajtëse me shumë në përputhje me Ligjin për kundërvajtjet. Nëse punëdhënësi nuk e pranon urdhërpagesën kundërvajtëse, inspektori përgjegjës do të parashtojë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse.

(2) Nëse punëdhënësi e përsërit kundërvajtjen nga nenet 56, 57 dhe 58 të këtij ligji, në afat prej një viti prej ditës së bërjes së kundërvajtjes, inspektori i punës me aktvendim do të ndalojë punë te punëdhënësi në hapësirën e punës, respektivisht hapësirën e punës në kohëzgjatje prej 30 ditësh dhe do të parashtojë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse, në përputhje me ligjin.

(3) Ankesa kundër aktvendimit të inspektorit të punës nga paragrafi (2) i këtij neni nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit."

Neni 3

Pas nenit 54 shtohet nen i ri 54-a si vijon:

"Neni 54-a

(1) Personat zyrtar të autorizuar janë të obliguar të mbajnë evidencë për urdhërpagesat e lëshuara kundërvajtëse dhe për rezultatin e procedurave të ngritura.

(2) Në evidencën nga paragrafi (1) i këtij neni, grumbullohen, përpunohen dhe ruhen të dhënat në vijim: emri dhe mbiemri, gjegjësisht emërtimi i kryesit të kundërvajtjes, vendbanimi, respektivisht vendqëndrimi, selia, lloji i kundërvajtjes, numri i urdhërpagesës kundërvajtëse që i lëshohet dhe rezultati i procedurës.

(3) Të dhënat personale nga paragrafi (2) i këtij neni ruhen pesë vite prej ditës së shënimit në evidencë.

(4) Ministri përgjegjës për punët në fushën e punës e përcakton formën dhe përmbajtjen e urdhërpagesës kundërvajtëse. “

Neni 4

Në nenin 56, paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

"(2) Gjorbë në shumë prej 30% të gjorbës së përcaktuar për personin juridik do i shqiptojë për kundërvajtjet nga paragrafi (1) i këtij neni personit përgjegjës te personi juridik."

Në paragrafin (3), numri "700" zëvendësohet me fjalët: "100 deri 150".

Neni 5

Në nenin 57, paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

"(2) Gjobë në shumë prej 30% të gjobës së matur për personin juridik do t'i shqiptohet për kundërvajtjet nga paragrafi 1 i këtij neni personit përgjegjës te personi juridik."

Në paragrafin (3), numri "1.500" zëvendësohet me fjalët "200 deri 300".

Neni 6

Në nenin 58, në paragrafin (1), fjalët "5.000 deri" shlyhen.

Paragrafi 2 ndryshohet si vijon:

"(2) Gjobë në shumë prej 30% të gjobës së përcaktuar për personin juridik do i shqiptohet për kundërvajtjen nga paragrafi 1 i këtij neni personit përgjegjës te personi juridik."

Në paragrafin (3), fjalët "4.000 deri 5.000" zëvendësohen me fjalët "800 deri 1.200."

Neni 7

Paragrafi 59 ndryshohet si vijon:

"Neni 59

Urdhërpagesë mandatore prej 50 eurosh në kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet të punësuarit, nëse nuk i respekton masat e përcaktuara për siguri dhe shëndet gjatë punës dhe nëse nuk e përdor pajisjen e përcaktuar për mbrojtje personale (neni 41, paragrafët (1) dhe (2)).

Neni 8

Matja e lartësisë së gjobës për personin juridik bëhet në përputhje me Ligjin për kundërvajtje.

Neni 9

Akti nënligjor miratimi i të cilit është përcaktuar me këtë ligj, do të miratohet në afat prej 30 ditësh prej ditës së hyrjes së këtij ligji në fuqi.

Neni 10

Autorizohet Komisioni juridiko-ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë të përpilojë tekst të spastruar të Ligjit për siguri dhe shëndet gjatë punës.

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi me ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".